



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

**V E N D I M**

**Nr. 42, Datë 12/03/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 154, datë 26.09.2018, e Znj. M.S., ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”, “gjendjes shoqërore”, “moshës”, “gjendjes shëndetësore” dhe “aftësisë së kufizuar”, nga ana Drejtorit të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se ankuesja M.S., e lindur në Berat, në datën 11.02.1960, është diplomuar “Agronome e Lartë” pranë Fakultetit të Agronomisë, të Institutit të Lartë Bujqësor, Tiranë, në vitin 1985. Prej vitit 1987 e në vijim, ankuesja ka punuar mësuese në institucione të ndryshme arsimore në varësi të DAR Berat. Në datën 01.09.1996 ajo është emëruar mësuese pranë Shkollës së Mesme “Kristo Isak”, Berat, ku ka vazhduar të japë mësim, deri në datën 07.10.2002. Në vijim, ka filluar sërish punën pranë të njëjtit institucion arsimor në datën 11.10.2005, ku ka dhënë mësim pa ndërprerje deri në datën 03.01.2019, datë në të cilën është zgjidhur kontrata e saj e punës, si pasojë e shkurtimit të vendimit të punës, për shkak të mungesës së ngarkesës mësimore, nëpërmjet Urdhërit nr. 92, datë 02.10.2018, të Drejtorit të Shkollës.

Ankuesja pretendon se në datën 16.09.2018 është njoftuar nga kolegët e saj të punës, se asaj nuk i ishin caktuar orë mësimi për vitin e ri arsimor, ndërkohë që nga titullari i institucionit arsimor

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

nuk e kishte marrë një njoftim të tillë. Znj. M.S. shprehet se në datën 19.09.2018 ka kërkuar takim me drejtorin e shkollës, i cili e ka njoftuar verbalisht, se i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Ankuesja shprehet se është mësuesja me përvojën më të madhe pranë kësaj shkolle dhe ka dhënë mësim për breza të tërë nxënësish. Ajo thekson faktin se në krye të dy viteve, del në pension, fakt që e bën tepër të rëndë, mënyrën se si po e largojnë nga puna. Ajo shprehet se nuk i është dërguar asnjë njoftim paraprak për zgjidhje të kontratës së punës, sikurse parashikohet në dispozitat e Kodit të Punës.

Me Vendimin nr. 82, datë 08.02.2018, të KMCAP-së, Znj. M.S. është cilësuar se është e aftë për punë me  $\frac{3}{4}$  e normës dhe përfiton të ardhura për invaliditet të pjesshëm. Ajo ka vendosur protezë në gjurin e majtë të këmbës dhe aktualisht trajtohet me pension invaliditeti. Për sa më sipër, ajo shprehet se është diskriminuar për shkak “gjendjes arsimore”, “gjendjes shoqërore”, “moshës”, “gjendjes shëndetësore” dhe “aftësisë së kufizuar”, nga ana Drejtorit të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat.

### **I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 154, datë 26.09.2018, së Znj. M.S., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>2</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorit të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, me shkresën nr. 1321/1, datë 01.10.2018, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

- Informacion i plotë, lidhur me pretendimet e Znj. M.S.;
- Nëse marrëdhëniet e punës me ankuesen janë ndërprerë, ose janë në proces ndërprerjeje, të sqarohet qartë motivacioni për zgjidhjen e kontratës së punës;
- Kopje e kontratës së punës së ankueses;
- Kopje e njoftimit për zgjidhje të kontratës së punës.
- Kopje e librezës së punës së ankueses;

---

<sup>2</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Kopje e aktit administrativ, nëpërmjet së cilit janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Znj. M.S.;
- Informacion, nëse ndaj Znj. M.S. janë marrë masa disiplinore gjatë kohës që ka punuar pranë Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat.
- Vlerësime për punën e kryer nga ankuesja ndër vite pranë Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat.
- Informacion nëse gjatë së njëjtës periudhë kohore janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me mësues të tjerë të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat. Nëse po, të dërgohet lista e tyre, në të cilën të pasqyrohet ditëlindja/mosha dhe arsimi.
- Çdo informacion tjetër që ka lidhje me çështjen e parashtruar nga ankuesja.

1. Drejtori i Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat nuk i dërgoi përgjigje shkresës nr. 1321/1, datë 01.10.2018, së Komisionerit.

C. Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore mbi ankesën nr. 154, datë 26.09.2018, e Znj. M.S., si dhe në mungesë të informacionit të nevojshëm, që nuk u dërgua nga Drejtori i Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, mbështetur në Urdhërin nr. 217, datë 06.11.2018, e KMD-së, në datën 19.11.2018, u krye inspektim pranë kësaj shkolle

Gjatë inspektimit pranë Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, inspektorët e KMD-së u takuan me Z. Ferik Koçi, Drejtor i kësaj shkolle. Z. Koçi dha sqarimet përkatëse, lidhur me ankesën e Znj. M.S.. Fillimisht ai i bëri me dije inspektorët e KMD-së se kjo shkollë ishte profesionale me disa drejtime. Këto drejtime ishin: ekonomik, hoteleri-turizëm, tekstil dhe konfeksion, teknologji ushqimore, bujqësi dhe së fundmi shërbim social. Për secilin nga drejtimit përkatëse jepnin mësim mësues të lëndëve profesionale dhe mësues të lëndëve të përgjithshme. Drejtuesi i shkollës u shpreh se Znj. M.S. i është zgjidhur kontrata e punës, si pasojë e mungesës së orëve mësimore për drejtimin Bujqësi, drejtim në të cilin ajo jepte mësim në lëndët profesionale. Drejtori i shkollës u shpreh se vitin e kaluar mësimor për drejtimin - Bujqësi ishin kryer vetëm 4 regjistrime nxënësish, ndërkohë që për vitin aktual mësimor nuk kishte asnjë regjistrim për këtë drejtim. I pyetur nëse kishte edhe drejtime të tjera, ku nuk kishte patur regjistrime nxënësish, ai u shpreh se në drejtimin Teknologji Ushqimore nuk kishte patur regjistrime nxënësish e si pasojë mësuesi<sup>3</sup> që jepte mësim në këtë degë, i cili punonte me kontratë me afat të caktuar, nuk i ishte rinovuar kontrata e punës për mësimdhënie në këtë drejtim, por në vijim ishte punësuar për drejtimin hoteleri-turizëm. I pyetur sërish nëse kishte edhe mësues të tjerë të cilëve u është zgjidhur kontrata e punës si pasojë e mungesës së ngarkesës mësimore, Z. Koçi u shpreh se edhe 2 mësuesve të tjerë<sup>4</sup>, të lëndëve të përgjithshme, u është zgjidhur kontrata e punës për të njëjtin shkak.

<sup>3</sup> Mëuesi në fjalë është diplomuar për teknologji ushqimore.

<sup>4</sup> Të dy mësuesit japin mësim gjuhë të huaja, përkatësisht gjermanisht dhe frëngjisht.

Në degën ose drejtimin Bujqësi kanë dhënë mësim 2 mësues të këtij profili, përkatësisht Znj. M.S. dhe Z. R. O. Ky i fundit ka përfunduar studimet e larta për Agronomi dhe Biokimi. Znj. M.S. është punësuar pranë kësaj shkolle që prej vitit 2005, ndërkohë që Z. Olldashi ka filluar punë në këtë shkollë në vitin 1993. Të dy kanë dhënë mësim në degën bujqësore. Ankuesja ka dhënë mësim lëndët “Bimët e arave”, “Përmirësimi ujqor”, “Lulet e Perimet”. Z. R.O. ka dhënë lëndët biologji-kimi që prej vitit 2012 dhe ka patur pak orë mësimore të profilit bujqësor. Sipas informacionit të marrë nga drejtuesi i shkollës, Z. R.O. i duhet të dalë në pension pas 7 vitesh. Për shkak të mungesës së orëve të punës në këtë degë, Znj. M.S. i janë filluar procedurat për zgjidhjen e kontratës së punës, ndërkohë që Z. R.O. vazhdon të japë mësim pranë kësaj shkolle, pasi ngarkesa e tij mësimore mbulohet me orë të edukimit të përgjithshëm, si biologji dhe kimi. Nga informacioni i administruar rezulton se asnjë mësues tjetër i kësaj shkolle, që jep lëndë profesionale, nuk është larguar nga puna për shkak të mungesës së ngarkesës mësimore. Drejtori i shkollës u shpreh, se Znj. M.S. ishte ende në afat njoftimi, pra nuk i ishin ndërprerë ende marrëdhëniet e punës dhe se procedurat për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të ishin kryer konform dispozitave të Kodit të Punës. Ai theksoi faktin se pavarësisht faktit se Znj. M.S. ishte brenda afatit të njoftimit dhe paguhej nga shkolla, ajo nuk paraqitej më në punë. Ndër të tjera, Z. Koçi u shpreh se vlerësimi në punë për ankuesen ka qenë i mirë dhe shumë i mirë dhe ndaj saj nuk është marrë ndonjë masë disiplinore. U ra dakord, që vlerësimet e punës së Znj. M.S. të dërgoheshin në vijim pranë KMD-së.

Znj. M.S. ka depozituar ankesën e datës 24.09.2018, në adresë të drejtorit të shkollës. Z. Koçi i ka kthyer përgjigje, nëpërmjet shkresës nr. 274, datë 28.09.2018. Ankuesja ka depozituar ankesë edhe pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, i cili ka kërkuar informacion përkatës nga Shkolla Profesionale “Kristo Isak”, Berat.

Drejtori i shkollës i informoi inspektorët se ankuesja ka depozituar padë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Berat, lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës nga drejtuesi i Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat. Z. Koçi u shpreh se procedura e zgjidhjes së kontratës së punës ishte e rregullt. Fillimisht, ankueses M.S. i është dërguar shkresa nr. 253, datë 25.09.2018 “Njoftim për organizimin e takimit për diskutimin e marrëdhënieve të punës”, në vijim i është dërguar shkresa nr. 275, datë 02.10.2018 “Njoftim për zgjidhjen e kontratës së punës”. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se Znj. M.S. nuk është paraqitur në takimin e datës 28.09.2018, gjë që vërtetohet nga procesverbali nr. 273, datë 28.09.2018, i takimit të sipërpërmendur. Në vijim, është miratuar Urdhëri nr. 92, datë 02.10.2018, i Drejtorit të Shkollës, ku përcaktohet ndërprerja e marrëdhënieve të punës me ankuesen në datën 02.01.2019.

Ndër të tjera, Z. Koçi u shpreh se në Shkollën “Myrteza Kepi”, e cila është shkollë vartëse e Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, çdo vit mësimor kanë ndodhur shkurtime të stafit mësimor, të degëve apo drejtimeve të ndryshme. Gjatë vitit aktual mësimor, sikurse edhe para dy vitesh mësimore,

pranë kësaj shkolle vartëse janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me 2 (dy) mësues, si pasojë e mungesës së ngarkesës mësimore.

1. Në vijim të inspektimit të kryer, Drejtori i Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, dërgoi shkresën nr. 132/4, datë 26.11.2018, në adresë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Bashkëlishur kësaj shkresë janë dërguar edhe disa prej akteve dhe shkresave të kërkuara nga Komisioneri.

Shkolla Profesionale “Kristo Isak”, Berat ofron mësimdhënie dhe aftësim profesional në 6 drejtime, përkatësisht: 1-Hoteleri-Turizëm, 2-Ekonomi-Biznes, 3-Bujqësi, 4-Tekstil dhe konfeksion, 5-Teknologji-Ushqimore dhe ne 2 vitet e fundit ofron edhe drejtimin Shërbimi Social dhe Shëndetësor. Për të 6 drejtimet ka patur promovim në vazhdimësi nga shkolla, por nuk është arritur të ketë regjistrime në drejtimet:

- Bujqësi (që prej vitit shkollor 2015-2016);
- Teknologji ushqimore (që prej vitit shkollor 2015-2016);
- Tekstil dhe konfeksion (nuk është arritur të hapet asnjëherë),
- Drejtimet mekanike dhe elektrike në shkollën vartëse në Kuçovë (që prej vitit 2015-2016).

Në kushtet kur, drejtimi Bujqësi, në vitin shkollor 2017-2018, kishte maturën e fundit dhe në vijim nuk pati regjistrime të reja për këtë vit shkollor, rezultoi se shkolla nuk dispononte më asnjë orë në profilin, në të cilën jep mësim Znj. M.S.. Për sa i përket kësaj shtate, mësuesja ka qenë në dijeni dhe i është komunikuar gjatë vitit shkollor se vazhdimësia e mësimdhënies varet nga regjistrimet e reja në këtë drejtim.

Në shkresë theksohet fakti se në ditën e parë të fillimit të shkollës, përkatësisht në datën 17.09.2018 është realizuar një takim me mësuesen, ku iu dhanë argumentat e mungesës së orëve. Mësuesja e agravuar për mungesën e ngarkesës mësimore u shpreh në mënyrë të ashpër dhe jo etike gjatë këtij takimi. Pavarësisht kësaj, ankueses iu theksua fakti se regjistrimet vazhdonin deri në fund të muajit shtator dhe nëse do të kishte regjistrime në drejtimin Bujqësi, vetëm atëherë mund të krijohet mundësia për vazhdimësinë e saj në këtë pozicion pune. Drejtori i Shkollës ka theksuar faktin se në asnjë moment nuk ka pasur agravim të sjelljes së tij dhe madje e ka sqaruar ankuesen se do të përfitonte nga të gjitha benefitet që i jepte ligji.

Në vijim, në zbatim dispozitave të Kodit të Punës, Znj. M.S. është njoftuar me shkresën nr. 253, datë 25.09.2018, me lëndë “Për organizimin e takimit për diskutimin e marrëdhënieve të punës”. Takimi i planifikuar për në datën 28.09.2018, ora 10:00 u mbajt në prani të drejtorit, sekretares së shkollës, financierit dhe një mësuesi, por në mungesë të mësueses M.S., e cila nuk u paraqit edhe pse kishte marrë njoftim verbalisht, sikurse edhe me postë, e konfirmuar kjo edhe me

lajmërim-marrjen nga Posta Shqiptare. Ky takim u dokumentua me procesverbalin nr. 273, datë 28.09.2018, i cili u vu edhe në dispozicion mësueses, duke e dërguar me postë në adresën e saj. Më pas me shkresën nr. 275, datë 02.10.2018, Znj. M.S. është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës pas përfundimit të periudhës së njoftimit prej 90 ditësh, në respektim të parashikimeve të Kodit të Punës dhe në të njëjtën datë ka dalë Urdhëri nr. 92, datë 02.10.2018, drejtuar Sektorit të Financës për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare dhe juridike, me ankuesen në datën 02.01.2019, si dhe për pagesën e shpërblimit për vjetërsi në punë sipas Kodit të Punës. Në shkresë theksohet fakti se është realizuar e gjithë procedura e njoftimit dhe marrëdhënia e punës me Znj. M.S. vazhdon deri në datën 02.01.2019.

Në shkresën nr. 132/4, datë 26.11.2018, e Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, theksohet fakti se e njëjta procedurë është ndjekur edhe për shkurtime të tjera, si më poshtë:

- Znj. S. Q., mësuese e gjuhës gjermane në vitin 2016;
- Z. L. A., mësues i gjuhës frënge në vitin 2016;
- Znj. K. Sh., mësuese specialiste për Mekanikë në vitin 2018 (28/08/2018);
- Z. F. D., mësues specialist për Drejtimin Mekanik, në vitin 2017;

Këto raste të zgjidhjes së kontratave të punës kanë ndodhur, pasi ndër vite ka rënë numri i regjistrimeve në disa drejtime/degë dhe ndërkohë janë hapur drejtime të tjera, që kërkojnë specialistë të fushave përkatëse.

Për sa i përket pretendimeve të ankueses se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore, shoqërore, moshës, gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar, Drejtori i shkollës sqaron se:

1. Në lidhje me pretendimin e Znj. M.S. për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, drejtori i shkollës shprehet se mësuesja M.S. është e vetmja mësuese në drejtimin Bujqësi dhe nuk ka pasur ndarje orësh, pasi mësuesi tjetër specialist, për të cilin Znj. M.S. ngre pretendim, disponon diplomë mësuesie të profilit Bio-kimi dhe ndër vite ka dhënë mësim në këtë profil, sikurse edhe për këtë vit mësimor;
2. Në lidhje me pretendimin e Znj. M.S. për diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore, titullari i Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, shprehet se nuk gjen asnjë motiv, me të cilin ankuesja e lidh këtë gjendje, pasi mësuesja ka që prej vitit 2005 që punon pa shpëputje nga puna dhe që nga momenti që ai drejton këtë institucion, nuk ka vënë re mënjanim apo mos shoqërim të kolektivit të punës me të;
3. Në lidhje me pretendimin e Znj. M.S. për diskriminim për shkak të gjinisë, drejtori i shkollës shprehet se momentalisht në stafin pedagogjik të shkollës që ai drejton, ka gjithësej 24 punonjës, nga të cilët 15 janë femra. Duke gjykuar nga numri i mësueseve që i përkasin

gjinisë femërore, që punojnë pranë kësaj shkolle, ai shprehet se nuk ekziston asnjë mundësi për të patur diskriminim të ankueses për shkak të gjinisë;

4. Për sa i përket pretendimit të ankueses për diskriminim për shkak të moshës, në shkresë theksohet fakti se Znj. M.S. nuk është e vetmja mësuese me këtë moshë, pasi momentalisht në kolektivin dhe stafin e mësuesve të kësaj shkolle bëjnë pjesë edhe mësues të tjerë në moshën e ankueses, të cilët ende punojnë dhe japin mësim pranë kësaj shkolle. Në këtë kontekst, drejtori i shkollës përmend mësuesit Z. N. (e datëlindjes 23.06.1959), Z. B. (i datëlindjes 12.08.1958), P. Z. (i datëlindjes 20.01.1956) dhe R. T. (i datëlindjes 07.09.1960).
5. Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore theksohet fakti se mësuesja M.S. ka qenë pjesë e stafit pedagogjik, në momentin që iu shfaq problemi shëndetësor në gju dhe në vijim kreu ndërhyrje për të vendosur protezë. Gjatë kohës së kryerjes së ndërhyrjes, Znj. M.S. i është dashur të shkëputet nga puna, për periudhën 09.09.2016 deri në datën 06.03.2017. Por, edhe pas kësaj periudhe të zgjatur kohore, mësuesja u rikthye në punë dhe i janë krijuar hapësira, si dhe është mirëkuptuar sa herë që ka pasur nevoja shëndetësore.
6. Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar në shkresën e dërguar nga Drejtori i Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat theksohet fakti se në respektim të ligjeve në fuqi, mësuesja M.S. ka punuar me 3/4 e normës, sikurse ishte vendosur në vendimin e KMCAP Berat. Për analogji silltet në vëmendje të KMD-së edhe rasti i mësuesit Hajri Taraj, i cili për shkaqe shëndetësore trajtohej me ¾ e normës së punës dhe ky mësues e vazhdoi marrëdhënien e punës me Shkollën Profesionale “Kristo Isak”, Berat, deri në momentin e daljes në pension, në datën 28/08/2018, pasi në profilin e tij kishte ngarkesë mësimore.

Në përfundim Drejtori i shkollës shprehet se nga gjithë sa më sipër del në pah fakti se nuk ka pasur diskriminim në asnjë aspekt dhe për asnjë shkak, për Znj. M.S.. Arsyeja e vetme e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me ankuesen, ka qenë vetem mungesa e orëve në profilin e diplomës së Znj. M.S..

Gjatë procedurës së kryerjes së njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, mësuesja M.S. ka dërguar një kërkesë, në datën 24.09.2018, për të cilën ka marrë përgjigje me shkresën nr. 274, datë 28.09.2018. Në vijim, pranë Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat është paraqitur një kërkesë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, të cilit i është dhënë informacioni i kërkuar me shkresën nr. 315, datë 24.10.2018.

Ndër të tjera, drejtori i shkollës e informon edhe një herë Komisionerin se në datën 01.10.2018, Znj. M.S. ka depozituar padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, lidhur me përfitimin e dëmshpërblimit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Në shkresën e dërguar nga Shkolla Profesionale “Kristo Isak”, Berat theksohet fakti se vlerësimi për mësuesen, në 2 vitet e fundit është “mirë” dhe ndaj saj nuk ka masa disiplinore në fuqi.

- D.** Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 14.12.2018, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqit ankuesja M.S. dhe Z. F. B., përfaqësues ligjor i Drejtorit të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, i cili depozitoi Autorizimin nr. 364 Prot., datë 04.12.2018, të lëshuar nga titullari i shkollës së sipërpërmendur, nëpërmjet së cilës ai autorizohet për përfaqësim në këtë seancë.

Ankuesja parashtrori edhe një herë pretendimet e saj, lidhur me çështjen objekt diskriminimi. Znj. M.S. theksoi faktin se paralelisht me të, ka dhënë mësim në të njëjtën degë, Z. R.O. Ankuesja sqaron se ndërkohë që ajo është larguar nga puna, Z. R. O. vazhdon ende të japë mësim pranë kësaj shkolle edhe pse ky i fundit është punësuar pranë këtij institucioni arsimor 10 vjet më vonë se ajo. Znj. M.S. u shpreh se në këtë shkollë ka disa mësues që japin mësim jashtë profilit të tyre.

Përfaqësuesi ligjor i drejtorit të shkollës u shpreh se çështja e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me ankuesen është në gjykim pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Berat. Ai theksoi faktin se shkak i vetëm i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me ankuesen është mungesa e ngarkesës mësimore. Për vitin mësimor 2018-2019 nuk ka patur regjistrime nxënësish për degën bujqësore dhe si rrjedhim nga dy mësues që jepnin mësim në këtë degë, u mbajt vetëm njëri. I pyetur përse është bërë kjo përzgjedhje, përfaqësuesi ligjor i titullarit të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat u shpreh se për këtë çështje do të dërgohej informacion me shkrim, në vijim të seancës dëgjimore, por shtoi se për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen është ndjekur një procedurë e rregullt ligjore. I pyetur se sa i ligjshëm është fakti që Z. R.O. jep mësim lëndët kimi-biologji, ndërkohë që është mësues i Degës së Bujqësisë, sërisht përfaqësuesi ligjor përgjigjet që informacion përkatës do ta japë me shkrim. Përfaqësuesit e KMD-së e pyetën ankuesen, nëse ajo ka dhënë orë jashtë profilit të saj, Znj. M.S. u përgjigj se edhe ajo ka dhënë orë jashtë profilit. Ajo sqaron se vitin e kaluar mësimor, ka dhënë mësim 8 orë brenda profilit të saj dhe 6 orë jashtë profilit, si dhe thekson faktin se të gjithë mësuesit kanë dhënë orë jashtë profilit të tyre për të plotësuar normën mësimore. E pyetur nëse janë kryer emërimet mësimor të rinj në këtë shkollë, ankuesja u përgjigj se është kryer vetëm një emërim i ri, i një mësuesje të profilit gjuhë-letërsi, e cila ishte brenda profilit të saj. Përfaqësuesi ligjor i drejtorit të shkollës u



pyet në seancë, nëse drejtori i shkollës me DAR Berat kishin menduar për ndonjë zgjidhje të mundshme punësimi për ankuesen, pasi ajo ishte pranë moshës së pensionit të pleqërisë. Përfaqësuesi ligjor u shpreh se përgjigjen mbi një pyetje të tillë do ta dërgonte me shkrim, sikurse edhe për të gjitha çështjet e tjera, për të cilat nuk kishte dhënë informacion, në adresë të KMD-së. Ndër të tjera, ai u shpreh se Znj. M.S. kishte në ngarkim 2 (dy) masa disiplinore, fakt që u kundërshtua nga ankuesja. Përfaqësuesit e KMD-së kërkuan që ky fakt të verifikohet dhe të dërgohet informacion me shkrim lidhur me këtë çështje.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Drejtori i Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, dërgoi pranë Komisionerit shkresën nr. 1787, datë 24.12.2018, ku informon mbi disa çështje të cilat ishin diskutuar në seancën dëgjimore.

Nëpërmjet shkresës së sipërpërmendur, fillimisht Komisioneri vihet në dijeni të faktit se procedura e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës së Znj. M.S. ka qenë e rregullt sipas parashikimeve përkatëse në dispozitat e Kodit të Punës. Arsyeja e zgjidhjes së kësaj kontrate ka qenë mungesa e ngarkesës mësimore. Baza ligjore, në të cilën është mbështetur titullari i institucionit arsimor për lirim nga detyra ka qenë Udhëzimi nr. 6, datë 24.02.2015, i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë “Për kriteret e përgjithshme dhe procedurat për marrjen në punës të personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional” (i ndryshuar) dhe Udhëzimi nr. 38, datë 06.10.2015, i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, ku parashikohet shprehimisht se mbarimi i marrëdhënies së punës së mësuesit me institucionin publik të arsimit parauniversitar bëhet, kur institucioni shkollor nuk ofron ngarkesë mësimore lëndore.

Në këtë kontekst, titullari i institucionit arsimor thekson faktin se zgjidhja e kontratës së punës është kryer për shkaqe shkaqe ligjore dhe arsyeja e vetme është fakti i mungesës së ngarkesës mësimore për ankuesen, pasi është ulur ndjeshëm numri i nxënësve të regjistruar për Degën Bujqësore pranë Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat. Në kushtet kur, nuk ekzistonte një pozicion i lirë pune për ankuesen dhe për sa kohë që organi administrative prej nga varet shkolla nuk kishte mundësi që ta punësonte ankuesen në një pozicion tjetër pune, Znj. M.S. iu zgjidh kontrata e punës me këtë institucion arsimor.

Lidhur me pretendimin e ankueses se ndaj saj nuk janë zbatuar procedurat e zgjidhjes së kontratës së punës të parashikuara në nenin 144, të Kodit të Punës, si dhe se punëdhënësi nuk ka zbatuar në mënyrë të rregullt asnjë nga fazat e parashikuara për procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës parashikuar në këtë nen, titullari i institucionit arsimor shprehet se një gjë e tillë nuk është e vërtetë, pasi nga ana e tij janë zbatuar me korrektësi të gjitha këto hapa e procedura. Kështu, fillimisht nëpërmjet shkresës nr. 253, datë 25.09.2018, ankuesja është

njoftuar për organizimin e takimit për diskutimin e marrëdhënieve të punës. Në datën 28.09.2018, ora 10:00 nga ana e përfaqësuesve të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat është mbajtur procesverbal nr. 273, datë 28.09.2018, ku rezulton qartë se ankuesja nuk është paraqitur fare në këtë takim. Nëpërmjet shkresës nr. 275, datë 02.10.2018, të titullarit të shkollës është kryer njoftimi për zgjidhjen e kontratës së punës. Me këtë shkresë është vendosur : *“Zgjidhja e kontratës së punës me Znj. M.S., mësuese e specialiteteve në Shkollën e Mesme Profesionale “Kristo Isak”, për shkak të shkurtimeve të vendit të punës si pasojë e mungesës së ngarkesës mësimore në profilin e diplomës që zotëron. Detyrimet dhe të drejtat tuaja vazhdojnë deri në datën 02.01.2019”.*

Me anë të shkresës së datës 24.09.2018, ankuesja i është drejtuar titullarit të shkollës, ku kërkon informacion dhe kopje të dokumentacionit përkatës. Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Drejtori i Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat ka dërguar shkresën nr. 274, datë 28.09.2018, në të cilën ankuesja është sqaruar si më poshtë vijon: *“Në përgjigje të shkresës tuaj të datës 24.09.2018, ju bëj me dije se marrëdhënia e punës nuk është ndërprerë dhe vazhdon edhe sot. Ju jeni njoftuar me shkresën nr. 253, datë 25.09.2018 për takimin sot më datë 28.09.2018, për të diskutuar mbi vazhdimin e marrëdhënies së punës tuaj. Pas kësaj do të njoftoheni për vazhdimin dhe nga momenti i njoftimit gjatë së cilit ju duhet të paraqiteni në punë.”* Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr. 92, datë 02.10.2018, të Drejtorit të shkollës është vendosur ndërprerje e marrëdhënies juridike të punës, si dhe marrëdhënies financiare me ankuesen në datën 02.01.2019.

Lidhur me faktin se përse mësuesi tjetër i degës Bujqësi, Z. R.O. vazhdon ende të punojë pranë kësaj shkolle, ndërkohë që me Znj. M.S. u zgjidh kontrata e punës, drejtori i Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat sqaron se Z. R.O. zotëron dy diploma të shkollës së lartë, përkatësisht Diplomë për Agronomi, si dhe Diplomë të lëshuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, pranë Universitetit “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, nëpërmjet së cilës ai gëzon titullin “Mësues i Kimisë dhe Biologjisë”. Mbështetur në sa më sipër, Z. R.O. ka dhënë mësim si në degën Bujqësore, ashtu edhe në lëndët e përgjithshme Kimi-Biologji. Orët dhe lëndët që ai jep mësim janë të përcaktuara në kopjet e regjistrave të lëshuara nga Shkolla e Mesme Profesionale “Kristo Isak”, të cilat janë dërguar bashkëlidhur shkresës. Njëkohësisht në shkresën nr.1787, datë 24.12.2018 theksohet fakti se përveç funksionit të mësuesit për lëndët e sipërpërmendura, Z. R.O. kryen edhe funksionin e Përgjegjës të Bazës. Ky cilësohet si një funksion i rëndësishëm që kërkon kohë dhe përkushtim të posaçëm dhe që Z. R.O. e kryen shumë mirë.

- Lidhur me pyetjen e bërë në seancë dëgjimore ndaj përfaqësuesit ligjor të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, se a është ligjërish e bazuar procedura për të dhënë mësim jashtë profilit të degës Bujqësi, për Z. R.O., i cili jep mësim edhe për lëndët Kimi e Biologji, duke marrë parasysh kontratën individuale të punës së lidhur ndërmjet tij dhe shkollës, titullari i kësaj shkolle sqaron se Z. R. O. nuk jep mësim jashtë profilit të tij pasi ai zotëron

Diplomën nr. 1617, lëshuar nga Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastër dhe mban titullin “Mësues i Kimisë dhe Biologjisë”. Në kontratën individuale të punës së lidhur ndërmjet Z. R. O. dhe Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat nuk përcaktohet profili i mësimdhënies.

- Lidhur me pyetjen e bërë në seancë dëgjimore ndaj përfaqësuesit ligjor të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, nëse është njoftuar Drejtoria Arsimore Rajonale Berat mbi zgjidhjen e kontratës së punës së ankueses, titullari i kësaj shkolle informon se DAR Berat nuk është njoftuar mbi një fakt të tillë, pasi Shkolla Profesionale “Kristo Isak”, Berat nuk ka varësi nga ky institucion, por nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, i cili është institucioni epror i drejtpërdrejtë, që është njoftuar lidhur me këtë çështje, sikurse edhe mbi ecurinë e rregjistrimeve të reja të nxënësve pranë kësaj shkolle si dhe për shkurtimin e pozicionit të punës.
- Lidhur me pyetjen e bërë në seancë dëgjimore ndaj përfaqësuesit ligjor të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, mbi masat disiplinore të dhëna ndaj ankueses përgjatë viteve që ajo ka punaur mësuese pranë kësaj shkolle, drejtori i shkollës sqaron se ndaj Znj. M.S. nuk është marrë asnjë masë disiplinore për shkelje të rregullores apo të etikës, apo për shkaqe, që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit. Në shkresë theksohet fakti se nga ana e përfaqësuesit ligjor të kësaj shkolle është bërë lapsus në seancë dëgjimore, kur është thënë që ndaj Znj. M.S. janë marrë dy masa disiplinore, pasi situata e ankueses është ngatërruar me një situatë tjetër, të ngjashme me atë të Znj. M.S..
- Lidhur me pyetjen e bërë në seancë dëgjimore ndaj përfaqësuesit ligjor të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, se cila do të ishte detyra që do të kryhej nga ana e Znj. M.S. deri në përfundim të afatit të njoftimit deri në datën 02.01.2019 dhe a kishte një punë konkrete për të në shkollë, Drejtori i Shkollës sqaron se është detyrim ligjor që buron nga neni 144 i Kodit të Punës, që të ndiqet e gjithë procedura për zgjidhjen e kontratës së punës me punëmarrësin, detyrim ky, që nuk lë vend për interpretim. Nga ana e punëdhënësit është zbatuar me përpikmëri e gjithë procedura e duhur dhe Znj. M.S. vazhdon të qëndronte në punë deri në datën 02.01.2019. Por, pavarësisht faktit se ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune, ajo nuk është paraqitur në punë dhe nuk është sjellë me korrektesë dhe përgjegjshmëri profesionale, sikurse u shpreh në seancë dëgjimore. Ankuesja duhej të paraqitej në punë deri në momentin e përfundimit të afatit të njoftimit dhe të kryente të gjitha detyrat që do t'i ngarkoheshin nga eprori i saj, pavarësisht detyrave konkrete që do t'i jepeshin për të zbatuar.
- Lidhur me pyetjen e bërë në seancë dëgjimore ndaj përfaqësuesit ligjor të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, nëse drejtori i shkollës dhe DAR kanë ndërmarrë ndonjë nismë për sistemimin e Znj. M.S. në punë, pra për rregullimin e situatës ekzistuese, në kushtet kur ajo për 2 (dy) vjet del në pension pleqërie, titullari i shkollës shprehet se largimi i

ankueses nga puna është kryer në mbështetje të plotë me Udhëzimin nr. 6, datë 24.02.2015, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë “Për kriteret e përgjithshme dhe procedurat për marrjen në punës të personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional” (i ndryshuar) dhe Udhëzimi nr. 38, datë 06.10.2015, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, si dhe nenit 144, të Kodit të Punës.

Në kushtet kur, gjendja ekzistuese nuk është krijuar për shkaqe abuzive, dallimi, përjashtimi, kufizimi apo preference gjatë ushtrimit të funksionit, por për shkaqe ligjore të parashikuara në udhëzimet përkatëse, përkatësisht atë të shkurtimit të vendimit të punës si pasojë e mungesës së ngarkesës mësimore në profilin e diplomës që zotëron ankuesja, megjithë dëshirën e mirë të drejtorit të shkollës, situata në fjalë nuk mund të gjejë rregullim.

Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 154, datë 26.09.2018, e Znj. M.S., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

## **II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezulton se ankuesja M.S., e lindur në Berat, në datën 11.02.1960, është diplomuar në vitin 1985 “Agronome e Lartë”, pranë Fakultetit të Agronomisë, të Institutit të Lartë Bujqësor, Tiranë. Prej vitit 1987 e në vijim, ankuesja ka punuar mësuese në institucione të ndryshme arsimore në varësi të DAR Berat. Në datën 01.09.1996, ajo është emëruar mësuese pranë Shkollës 8-vjeçare “Kristo Isak”, Berat<sup>5</sup>, ku ka vazhduar të japë mësim, deri në datën 07.10.2002, ku është shkeputur për t’u punësuar pranë DAR Berat. Në vijim në datën 11.10.2005, ka filluar sërish punë pranë të njëjtit institucion arsimor, ku ka dhënë mësim pa ndërprerje deri në datën 02.01.2019, datë në të cilën është zgjidhur kontrata e saj e punës, si pasojë e shkurtimit të vendit të punës, për shkak të mungesës së ngarkesës mësimore, nëpërmjet Urdhërit nr. 92, datë 02.10.2018, të Drejtorit të Shkollës. Marrëdhëniet e punës ndërmjet ankueses M.S. dhe Shkollës së Mesme “Kristo Isak”, Berat, rregulloheshin nëpërmjet kontratës individuale të punës, me afat të pacaktuar.

<sup>5</sup> Në vitin 1996, Shkolla “Kristo Isak” ishte shkollë 8-vjeçare.

Shkolla Profesionale “Kristo Isak”, Berat ofron mësimdhënie dhe aftësim profesional në 6 drejtime, përkatësisht: 1-Hoteleri-Turizëm, 2-Ekonomi-Biznes, 3-Bujqësi, 4-Tekstil dhe konfeksion, 5-Teknologji-Ushqimore dhe në 2 vitet e fundit ofron edhe drejtimin Shërbimi Social dhe Shëndetësor. Në kuadër të reformimit të arsimit profesional, në vitin 2013, Shkolla e Mesme Profesionale “Kristo Isak”, Berat është shkëputur nga varësia e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë e DAR Berat dhe aktualisht ndodhet në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Organika e Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat është përcaktuar nëpërmjet shkresës nr. 1230, datë 24.02.2017, të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë<sup>6</sup>. Në këtë organikë bëjnë pjesë 43 punonjës, përkatësisht: 1 (një) drejtor, 1 (një) sekretar, 2 (dy) zëvendës drejtorë, 7 (shtatë) mësues të kulturës profesionale, 16 (gjashtëmbëdhjetë) mësues të kulturës së përgjithshme, 2 (dy) teknike të mesëm (instrukturë), 1 (një) psikolog, 1 (një) përgjegjës i bazës prodhuese/didaktike/laborator, 4 (katër) punëtorë të bazës prodhuese, 1 (një) kryetar Dege Finance-Administrim, 1 (një) magazinier, 3 (tre) sanitarë, 3 (tre) roje. Njëkohësisht, nëpërmjet kësaj shkrese është përcaktuar edhe organika (pjesore) për Shkollën e Mesme “Myrteza Kepi”, Berat, e cila përbëhet nga 3 mësues të kulturës profesionale. Kjo shkollë është shkollë vartëse e Shkollës së Mesme Profesionale “Kristo Isak”, Berat.

Për sa më sipër rezulton se në organikën e kësaj shkolle përcaktohet numri i përgjithshëm i mësuesve të kulturës profesionale, i cili është 7 të tillë. Ndërkohë që, drejtori i shkollës përcakton profilet e tyre sipas nevojave përkatëse të shkollës që drejton.

Znj. M.S. ka dhënë mësim në Drejtimin “Bujqësi” pranë kësaj shkolle, pasi edhe arsimimi i saj është agronome e lartë. Në Drejtimin “Bujqësi” pranë Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, deri në vitin shkollor 2017-2018, jepnin mësim dy mësues të kulturës profesionale, përkatësisht Znj. M.S. dhe Z. R.O. Ky i fundit përveç lëndëve të këtij drejtimi, jep mësim edhe në lëndët mësimore Kimi dhe Biologji, pasi përveç arsimimit si agronom i lartë, është i diplomuar pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, pranë Universitetit “Eqerem Çabej” Gjirokastër dhe gëzon titullin “Mësues i Kimisë dhe Biologjisë”. Përgjatë procesit të hetimit rezultoi, se Znj. M.S. mbante peshën kryesore të ngarkesës mësimore të këtij drejtimi, ndërkohë që norma mësimore e Z. R. O. plotësohej me orë mësimore të profilit Kimi-Biologji.

Në bazë të gërmës D), të Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” ngarkesa mësimore për një mësues është 22 orë mësimore. Në kushtet kur me Vendimin nr. 82, datë 08.02.2018, të KMCAP-së, Znj. M.S. është cilësuar se është e aftë për punë me  $\frac{3}{4}$  e normës, ngarkesa e saj mësimore ka qenë 16 orë mësimore. Për vitin shkollor 2016-2017 rezulton se norma mësimore për Znj. M.S. ka qenë 16 orë në drejtimin Bujqësi, ndërkohë

<sup>6</sup> Shkolla e Mesme Profesionale “Kristo Isak”, Berat ka kaluar në vitin 2013, me Vendim të Këshillit të Ministrave, në varësi të Ministrisë së Mirëqënies Sociale. Në vijim, pas suprimimit të kësaj Ministrie, kjo shkollë kaloi në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë.

që Z. R.O. ka patur 11 orë ngarkesë mësimore në këtë profil. Për vitin shkollor 2017-2018, ankuesja ka patur 7 orë mësimore në profilin Bujqësi dhe 8 orë të tjera janë plotësuar me Module H-T. Për këtë vit shkollor, Z. R.O. ka patur 2 orë mësimore në profilin Bujqësi dhe 8 orë në Biologji. Z. Olldashi përmbush gjithashtu edhe funksionin e Përgjegjësit të Bazës pranë kësaj shkolle. Përgjatë vitit shkollor 2018-2019, Z. Olldashi është profilizuar vetëm në Biokimi dhe me detyra si përgjegjës i bazës praktike. Sikurse vihet re, përgjatë 2-3 viteve arsimore të fundit rezultojnë të ketë rënë ngarkesa mësimore në degën Bujqësi, derisa për vitin mësimor aktual nuk ekziston më një drejtim i tillë.

Numri i regjistrimeve të nxënësve pranë kësaj shkolle ka filluar të pakësohet nga viti në vit përgjatë disa viteve arsimore, për disa drejtime ose degë. Për drejtimin “Bujqësi” numri i nxënësve ka filluar të pakësohet që prej vitit shkollor 2015-2016. E njëjta gjë ka ndodhur edhe për drejtimin Teknologji Ushqimore. Drejtimi Tekstil dhe Konfeksion nuk është arritur të hapet asnjëherë, pasi nuk ka patur regjistrime nxënësish. Për drejtimet Mekanike dhe Elektrike në shkollën vartëse në Kuçovë pakësimi i numrit të nxënësve të regjistruar ka filluar, që prej vitit arsimor 2015-2016.

Në kushtet kur, drejtimi Bujqësi, në vitin shkollor 2017-2018, kishte maturën e fundit dhe në vijim, për vitin shkollor 2018-2019 nuk pati regjistrime të reja, rezultoi se shkolla nuk dispononte ngarkesë mësimore në Drejtimin Bujqësi. Në këto kushte, titullari i Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat ka filluar procedurat për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen M.S., e cila sikurse u përmend më sipër mbante ngarkesën kryesore mësimore për drejtimin e Bujqësisë.

Në ankesën e saj, ankuesja pretendon se nuk është njoftuar nga Drejtori i Shkollës për mungesën e ngarkesës mësimore, si dhe nuk i është dërguar asnjë njoftim paraprak për zgjidhjen e kontratës së punës, sikurse parashikohet në dispozitat e Kodit të Punës.

Nga dokumentacioni i administruar përgjatë procesit të hetimit administrativ rezultojnë se titullari i Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, e ka njoftuar ankuesen M.S. për të diskutuar në datën 28.09.2018, mbi kontratën e punës me afat të pacaktuar të lidhur mes tyre, nëpërmjet shkresës nr. 253 prot., datë 25.09.2018, konform parashikimit të nenit 141 e vijues të Kodit të Punës. Shkolla Profesionale “Kristo Isak”, Berat ka depozituar në cilësinë e provës lajmërim marrjen përkatëse nga ku rezultojnë se ankuesja e ka marrë në dorëzim nga shërbimi postar shkresën e sipërpërmendur dhe ka nënshkruar në këtë lajmërim marrje. Referuar Proçesverbalit nr. 273, datë 28.09.2018, të mbajtur nga përfaqësuesit e shkollës, pjesëmarrës në takim, rezultojnë se ankuesja M.S. nuk është paraqitur në këtë takim për të biseduar mbi vazhdimësinë e marrëdhënies së punës edhe pse ka patur dijeni për të. Punëdhënësi i është drejtuar sërish ankueses me shkresën nr. 275, datë 02.10.2018, “Njoftim për zgjidhjen e kontratës së punës”, ku e njofton mbi vendimarrjen e tij, për zgjidhjen e kontratës së punës, për shkak të shkurtimit të vendit të punës, si pasojë e mungesës së ngarkesës mësimore në profilin e diplomës që zotëron. Në këtë shkresë

citohet: *“Vendosa: Zgjidhjen e kontratës së punës me Znj. M.S., Mësuese e specialiteteve në shkollësn “Kristo Isak”, për shkak të shkurtimit të vendit të punës si pasojë e mungësës së ngarkesës mësimore në profilin e diplomës që zotëron”. Detyrimet dhe të drejtat tuaja vazhdojnë deri më datë 02.01.2019”.* Në vijim të shkresës së mësipërme, nëpërmjet Urdhërit nr. 92, datë 02.10.2018, të Drejtorit të Shkollës vendoset ndërprerja e marrëdhënies juridike dhe financiare të punës për Znj. M.S. në datën 02.10.2019, me motivacionin e mungësës së ngarkesës mësimore në profilin e diplomës që ajo zotëron. Në këtë urdhër përcaktohet shprehimisht që Znj. M.S. të përfitojë edhe shpërblimin për vjetërsi në punë.

Mbështetur në provat shkresore të administruara rezulton se Znj. M.S. ka patur dijeni zyrtarisht lidhur me zgjidhjen e kontratës së saj të punës. Ankuesja ka depozituar kërkesën e datës 24.09.2018, pranë Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat, nëpërmjet së cilës kërkon kopje të dosjes së saj personale, si dhe çdo dokumenti tjetër, që ka lidhje me zgjidhjen e kontratës së saj, të punës. Titullari i shkollës i ka kthyer përgjigje ankueses nëpërmjet shkresës nr. 274, datë 28.09.2018 nëpërmjet së cilës e sqaron: *“Ju jeni njoftuar me shkresën nr. 253, datë 25.09.2018 për takim sot ne datën 28.09.2018, për të diskutuar mbi vazhdimin e marrëdhënies së punës suaj. Pas kësaj ju do të njoftoheni për vazhdimin dhe nga momeneti i njoftimit ju do të keni 90 ditë periudhë njoftimi gjatë së cilës ju duhet të paraqiteni në punë. Pas kësaj periudhe njoftimi ju ndërpritet marrëdhënia e punës.”*

Znj. M.S. depozitoi kërkesë-padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat kundër Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat. Objekti i kërkesë-padisë konsistonte si më poshtë: (1) Shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga zgjidhja e menjëherëshme dhe e pajustificuar e kontratës së punës, në masën 12 paga mujore. (2) shpërblim për moszbatim të afatit të njoftimit, në masën e tre pagave mujore, (3) shpërbim për moszbatim të procedurave sipas nenit 144 të kodit të punës, në masën 2 muaj pagë; (4) shpërblim për vjetërsi në punë.

Me vendimin nr. 69, datë 29.01.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat vendosi pranimin e pjesshëm të padisë së paditëses M.S. dhe detyrimin e të paditurit të shpërblejë paditësen me 12 muaj pagë për vjetërsi në punë. Për pjesën tjetër të padisë, gjykata vendosi rrëzimin e saj. Në arsyetimin e saj, gjykata u shpreh se: *“Nga provat e administruara në gjykim nuk kemi të bëjmë me zgjidhje të menjëherëshme të kontratës së punës, por kemi të bëjmë me zgjidhje normale të kontratës së punës në përfundim të afatit të njoftimit.... 14. Në gjykim i padituri arriti të provojë shkresërisht se ai ka zbatuar procedurat e zgjidhjes së kontratës së punës të parashikuara nga neni 144 i Kodit të Punës.”*

Në vendimin e sipërpërmendur rezulton se punëdhënësi nuk i ka dhënë *de facto* ankueses shpërblimin për vjetërsi në punë, pavarësisht se një gjë të tillë e ka parashikuar në praktikën përkatëse për zgjidhjen e kontratës së punës. Gjykata ka kryer përlllogaritjen përkatëse dhe ka

përcaktuar detyrimin e Shkollës Profesionale “Kristo Isak” Berat për ta dëmshpërblyer ankuesen me 12 paga mujore.

Vendimi nr. 69, datë 29.01.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është ankimuar nga ana e paditëses/ankueses, pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se procedurat për zgjidhjen e kontratës së punës së Znj. M.S. janë zhvilluar sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Punës, ndërkohë që me vendimin e sipërpërmendur të gjykatës është vendosur edhe masa e dëmshpërbimit të ankuesës për vjetërsinë e punës, ku si e tillë është cilësuar vjetërsia e saj në punë në tërësi dhe jo vetëm vitet e punësimit të ankueses pranë Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat.

Neni 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)<sup>7</sup> ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në rastin konkret Shkollës së Mesme “kristo Isak”, Berat. Në kushtet kur Shkolla e Mesme Profesionale “Kristo Isak”, Berat ka patur barrën e provës për të provuar se ankuesja nuk është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, fillimisht i ka bërë të ditur Komisionerit se zgjidhja e kontratës së punës me Znj. M.S. është kryer në bazë të parashikimeve të Udhëzimit nr. 6, datë 24.02.2015, i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë “Për kriteret e përgjithshme dhe procedurat për marrjen në punës të personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional” (i ndryshuar) dhe Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”.

Në kreun V, gërma e), të Udhëzimit nr. 6, datë 24.02.2015, i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë “Për kriteret e përgjithshme dhe procedurat për marrjen në punës të personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional” parashikohet: “Përfundimi i marrëdhënies së punës së personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike, bëhet kur:

.....

---

<sup>7</sup> Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”



*e. Institucioni reformohet, mbyllet, ose shkurtohet vendi i punës.”*

Ndërkohë që, në pikën 3, të Kreut 8, të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit *“Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”* parashikohet:

*“Mbarimi i marrëdhënies së punës së mësuesit me institucionin publik të arsimit parauniversitar bëhet:*

- a) Kur jep dorëheqjen;*
- b) Kur mbush moshën e pensionit;*
- c) Kur bëhet i paaftë për kryerjen e detyrave për shkaqe fizike ose mendore;*
- d) Kur dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës;*
- e) Kur merret masa disiplinore e largimit nga puna;*
- f) Kur institucioni shkollor nuk ofron ngarkesë mësimore.”*

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se në rastin e Znj. M.S. nuk mund të zbatohet parashikimi i gërma e), të Kreut V, të Udhëzimit nr. 6, datë 24.02.2015, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë *“Për kriteret e përgjithshme dhe procedurat për marrjen në punës të personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional”*, pasi nuk rezulton që të jetë miratuar një organikë e re për vitin 2018, nga ana e Ministrisë përgjegjëse, për Shkollën Profesionale “Kristo Isak”, Berat, ku të jetë shkurtuar numri i mësuesve të kulturës profesionale nga 7 (shtatë), në 6 (gjashtë). Drejtori i kësaj shkolle nuk ka tagër miratimin e organikës së shkollës, por përcakton profilizimin e mësuesve të kulturës profesionale, brenda numrit të përcaktuar në organikën e miratuar nga ministria përgjegjëse.

Por, pavarësisht sa më sipër, mbështetur në parashikimin e pikës 3, të Kreut 8, të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit *“Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”*, drejtori i kësaj shkolle ka qenë i legjitimuar për të kryer përfundimin e marrëdhënies së punës me Znj. M.S., në mungesë të ngarkesës mësimore.

Njëkohësisht, vlen të theksohet fakti se titullari i Shkollës Profesionale “Kristo Isak” ka përcjellë pranë Komisionerit praktika të mësuesve të tjerë të kësaj shkolle, të cilëve përgjatë 2-3 viteve të fundit u është zgjidhur kontrata e punës, sikurse ankueses, për shkak të mungesës së ngarkesës mësimore. Të tillë janë: Z. L.A., Z. F.D., Znj. K.Sh.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, Znj. M.S. nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të barabartë nga ana e Shkollës Profesionale “Kristo Isak, Berat.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e Shkollës Profesionale “Kristo Isak, Berat ndaj ankueses, nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkaqet e pretenduara nga Znj. M.S..

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 17 dhe nenin 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pika 4, gërma dh), si dhe pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pikës 3, të Kreut 8, të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, si dhe gërmës D), të Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të Znj. M.S., për shkaqet e pretenduara në ankesë, nga ana Drejtorit të Shkollës Profesionale “Kristo Isak”, Berat.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**

Fusha – punësim

Shkak -“gjendja arsimore”, “gjendja shoqërore”, “mosha”, “gjendja shëndetësore” dhe “aftësia e kufizuar”